

VENDIM
Nr. 433, datë 26.6.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 600, DATË 9.10.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E SHËRBIMIT TË SIGURISË PUBLIKE NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE TË KRITEREVE PËR
OFICERËT E SIGURISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjala e parë, e pikës 1, të vendimit nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar të mesëm të lartë, që kanë jo më pak se 80 nxënës, dhe në institucionet e arsimit parauniversitar bazë, që kanë jo më pak se 600 nxënës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama